



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

Nr. 4 prot

Tiranë, më 4.8.2017

VENDIM
Nr. 3, datë 4.8.2017.

“PËR
MIRATIMIN E METODOLOGJISË DHE MASËS SË TARIFAVE TË
SHPËRBLIMIT TË VEPRAVE TË MBROJTURA NGA E DREJTA E AUTORIT
NË SISTEMIN E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV”.

Në zbatim të nenit 156, nenit 142 e në vijim, të ligjit nr. 35, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; të pikës 4 dhe 5, të kreut II të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.35, datë 18.01.2017 “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit”; vendimit nr.2, datë 20.04.2017 “Për miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA)”, Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv në Republikën e Shqipërisë, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi, i cili është dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës si dhe në Fletore Zyrtare.
3. Kundër vendimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit palët kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën Administrative kompetente në afatet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative. Afati i ankimit llogaritet nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
4. Ngarkohet sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij vendimi.

SEKRETARI I KKDA
EDMOND AHMETI



KRYETAR

INES MUÇOSTEPA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

ANEKSI 1

MBI MIRATIMIN E METODOLOGJISË DHE MASËS SË TARIFAVE
TË SHPËRBLIMIT TË VEPRAVE TË MBROJTURA
NGA E DREJTA E AUTORIT NË SISTEMIN E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

KREU I
PËRKUFIZIME

1. **“Agjenci e Administrimit Kolektiv (AAK)”** nënkupton subjektin juridik, të krijuar më parë nga mbajtësit e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to dhe e licencuar nga ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit si agjenci me objekt të veprimtarisë së saj administrimin e një, dy ose më shumë kategori të drejtash, me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga përdorimi i veprave për të cilat janë autorizuar nga mbajtësit e këtyre të drejtave dhe shpërndarjen e tyre tek anëtarët e tyre-mbajtës të së drejtave, duke mbajtur detyrimet tatimore, si agjent tatimor sipas parashikimeve ligjore.
2. **“Vepër e mbrojtur nga e drejta e autorit”** nënkuptohen të gjitha kategoritë e veprave objekt i nenit 8 të ligjit 35/2016.
3. **“Të ardhura bruto”** nënkupton të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit të deklaruar në pasqyrën financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të përdoruesit. Nuk përfshihen në të ardhurat bruto nga veprimtaria vjetore e përdoruesit:
 - a) të gjitha të ardhurat që rrjedhin nga aktivitete të tjera të OSHMA-ve si shitja e mallrave dhe produkteve;
 - b) të ardhurat nga reklama për prodhime të vetë OSHMA-ve;
 - c) të ardhurat që sigurohen nga përdorime të veprave të mbrojtura që krijohen gjatë marrëdhënieve të punësimit;
 - ç) të ardhurat që krijohen nga sponsorizime, financime, kredi, grante, të lidhura dhe të ngjashme;
 - d) të ardhurat nga veprat për të cilat subjekti përdorues ka paguar në mënyrë direkte jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

dh) të ardhurat që krijohen nga shitja ose distribucioni i të drejtave mbi programet e veta dhe paketave me programe të vetë OSHMA-ve brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

e) të ardhurat nga investimet, projektet teknike të zhvillimit, kosto të tjera që lidhen me pagesa për licencime si OSHMA që nuk lidhen me përdorimin e veprës së mbrojtur nga ligji;

ë) të ardhurat që krijohen nga publikimi në mediat sociale/internet, shitja ose distribucioni i të drejtave të programeve të veta dhe paketave me programe të vetë OSHMA-ve brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

f) të ardhurat që krijohen nga përdorimi i të drejtave të autorit për të cilat subjekti përdorues hyn në marrëdhënie direkte me autorin/mbajtësin e të drejtave;

g) të ardhurat që krijohen nga blerja dhe shitja e veprave/enteve që nuk mbrohen nga ligji.”

4. **“Tarifë fikse”** nënkuptohet përkufizimi i nenit 149 të ligjit 35/2016.
5. **“Sporteli unik”** nënkuptohet agjencia që kryen funksionin e mbledhjes së tarifave të shpërblimit nga subjektet përdorues, në emër të agjencive të licencuara, për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave objekt përfaqësimi, që krijohet me marrëveshje me shkrim ndërmjet agjencive të licencuara të administrimit kolektiv ose sipas rastit me anë të vendimarrjes së KKDA-së.
6. **“Subjekti përdorues”**–nënkupton çdo operator që kryen veprimtari fitimprurëse ose jo në territorin e Republikës së Shqipërisë i cili konsumon/shfrytëzon vepra të mbrojtura nga ligji i të drejtës së autorit objekt përfaqësimi nga sporteli unik/AAK-të.
7. **“Ofrues shërbimi mediatik audioviziv (OSHMA)”** është personi fizik ose juridik, që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

8. **“Kohëzgjatja”** nënkupton raportin e shprehur në përqindje të kohës së përdorimit të veprës së mbrojtur nga sporteli unik/AAK-të në programacionin ditor (24 orë) nga subjekti përdorues.
9. **“Programacion”** nënkupton aktivitetet dhe programet e ndryshme ditore që përdorin operatorët transmetues dhe ritransmetues (OSHMA).
10. **“Program radio”** nënkuptohet tërësia e mesazheve audio që përbëjnë një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit radio.
11. **“Program televiziv”** nënkuptohet tërësia e imazheve lëvizëse, me ose pa zë, që përbëjnë një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv. Shembujt e programeve përfshijnë filma, ngjarje sportive, komedi, dokumentarë, programe për fëmijë dhe drama origjinale.
12. **“Destinacion turistik”** nënkupton pikën turistike me një përqendrim të lartë të produkteve turistike, i ngritur mbi bazën e studimeve dhe planeve të zonës dhe që ka kapacitete për të tërhequr vizitorë, vendas e të huaj, duke plotësuar e kënaqur kërkesat e tyre.
13. **“Strukturë akomoduese”** nënkuptohet struktura që vë në dispozicion të turistëve, vendas apo të huaj, individë ose të organizuar në grupe, për një periudhë kohe të pacaktuar, por jo më shumë se 1 vit, shërbimet e akomodimit (fjetje, ushqim, pije dhe shërbime të tjera), në përputhje me standardet e përcaktuara sipas klasifikimit dhe kategorizimit të saj.
14. **“Abonim”** nënkuptohet kontrata e shërbimit, lidhur midis ofruesit të shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA) me pagesë dhe marrësit të këtyre shërbimeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

KREU II

**TARIFA PËR KOMUNIKIMIN NË PUBLIK NË RADIO TË VEPRËS SË
MBROJTUR ¹**

Metodologjia dhe masa e tarifave të shpërblimit e aplikueshme për të gjithë subjektet RADIOFONIKE llogaritet sipas tabelës nr.1 dhe nr.2 më poshtë.

I. RADIO KOMBËTARE PUBLIKE / PRIVATE

Tabela nr.1

Kohëzgjatja e komunikimit në publik të veprës së mbrojtur në programacionin 24 orësh	deri në 35%	36% deri në 65%	mbi 65%
Tarifa në përqindje mbi të ardhurat bruto vjetore	2%	3%	4%
Formula e llogaritjes së tarifës	2% * totali i të ardhurave bruto	3% * totali i të ardhurave bruto	4% * totali i të ardhurave bruto

II. RADIO LOKALE

Tabela nr.2

Kohëzgjatja e komunikimit në publik të veprës së mbrojtur në programacionin 24 orësh	(deri në 35%)	(36% deri në 65%)	(mbi 65%)
Tarifa në përqindje aplikuar mbi të ardhurat bruto vjetore mbi kufirin prej 5 milion lekë	1%	2%	3%

Formula e llogaritjes së tarifës	1% * totali i të ardhurave bruto mbi 5 mln lekë + tarifën fikse	2% * totali i të ardhurave bruto mbi 5 mln lekë + tarifën fikse	3% * totali i të ardhurave bruto mbi 5 mln lekë + tarifën fikse
----------------------------------	---	---	---

¹ “Komunikimi në publik” nënkupton komunikimin në publik të një vepre të mbrojtur nga ligji i të drejtës së autorit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

TARIFA FIKSE

Tabela nr.3

	Banorë '000	(deri në 35%) / Lekë	(36% deri në 65%) / Lekë	(mbi 65%) / Lekë
Tarifë fikse përllogaritet në bazë të numrit të popullsisë të përcaktuar në licencë	Nën 20	10.000	20.000	30.000
	20- 60	15.000	30.000	50.000
	60 - 100	40.000	80.000	120.000
	100 - 150	50.000	100.000	150.000
	150 - 200	60.000	120.000	180.000
	200 - 300	70.000	140.000	220.000
	300 - 500	80.000	160.000	250.000
	500 - 700	90.000	180.000	270.000
	Mbi 700	100.000	200.000	300.000

Sqarime:

- 1) Nëse subjekti përdorues Radiofonik i veprës së mbrojtur realizon të ardhura bruto vjetore më pak se 5 milion lekë në vit, tarifa për t'u paguar është sa niveli i tarifës fikse të përcaktuar sipas klasifikimeve përkatëse në bazë të numrit të popullsisë dhe kohëzgjatjes së komunikimit në publik;
- 2) Në rastet kur subjekti përdorues Radiofonik i veprës së mbrojtur siguron të ardhura bruto vjetore mbi 5 milion lekë, por nuk paraqet formularin e deklaramit të tyre, tarifa e detyrueshme për t'u paguar është sa dyfishi i tarifës fikse të përcaktuar sipas klasifikimeve përkatëse në bazë të numrit të popullsisë dhe kohëzgjatjes së komunikimit në publik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

KREU III
TARIFA PËR KOMUNIKIMIN NË PUBLIK NË TELEVISION TË VEPRËS SË
MBROJTUR

Metodologjia dhe masa e tarifave të shpërblimit e aplikueshme për të gjithë subjektet përdorues TELEVISION², llogaritet sipas tabelës nr. 1, nr.2 dhe nr.3 më poshtë.

I. TELEVISION KOMBËTAR PUBLIK / PRIVAT

Tabela nr.1

Kohëzgjatja e komunikimit në publik të veprës së mbrojtur në programacionin 24 orësh	(deri në 10%)	(11% deri në 35%)	(36% deri në 65%)	(mbi 65%)
Tarifa në përqindje mbi të ardhurat bruto vjetore	1%	2%	3%	4%
Formula e llogaritjes së tarifës	1% * të ardhurat bruto	2% * të ardhurat bruto	3% * të ardhurat bruto	4% * të ardhurat bruto

Sqarime:

- 1) Në rastet kur subjekti përdorues nuk deklaron të ardhurat bruto vjetore, tarifa e pagueshme është sa tarifa vjetore më e lartë e paguar për AAK-të / sportelin unik nga subjekte përdorues të të njëjtës kategori (publike ose private) në tre vitet e fundit.

² Në kategorinë “TELEVIZION” përfshihen edhe subjektet e pajisura me autorizimin nga organi kompetent për të ofruar shërbim Internet TV (streaming), si për shembull: Zjarr TV ose Wedding Channel.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

II. TELEVIZIONE LOKALE

Tabela nr.2

Kohëzgjatja e komunikimit në publik të veprës së mbrojtur në programacionin 24 orësh	(deri në 10%)	(11% deri në 35%)	(36% deri në 65%)	(mbi 65%)
Tarifa në përqindje aplikuar mbi të ardhurat bruto vjetore mbi kufirin prej 5 milion lekë	1%	2%	3%	4%
Formula e llogaritjes së tarifës	1% * të ardhurat bruto mbi 5 milion + tarifën fikse	2% * të ardhurat bruto mbi 5 milion + tarifën fikse	3% * të ardhurat bruto mbi 5 milion + tarifën fikse	4% * të ardhurat bruto mbi 5 milion + tarifën fikse

TARIFA FIKSE

Tabela nr.3

	Banorë '000	(deri në 10%) / Lekë	(11% deri në 35%) / Lekë	(36% deri në 65%) / Lekë	(mbi 65%) /Lekë
Tarifë fikse sipas numrit të popullsisë të përcaktuar në licencë	Nën 20	40,000	60,000	85,000	120,000
	20 - 60	60,000	95,000	140,000	200,000
	60 - 100	160,000	240,000	360,000	480,000
	100 - 150	200,000	320,000	440,000	600,000
	150 - 200	240,000	360,000	520,000	720,000
	200 - 300	280,000	480,000	680,000	880,000
	300 - 500	320,000	520,000	720,000	1,000,000
	500 - 700	360,000	600,000	840,000	1,080,000
	Mbi 700	400,000	680,000	960,000	1,200,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

Sqarim:

- 1) Nëse subjekti përdorues TV i veprës së mbrojtur realizon të ardhura bruto vjetore më pak se 5 milion lekë në vit, tarifa për t'u paguar është sa niveli i tarifës fikse të përcaktuar sipas klasifikimeve përkatëse në bazë të numrit të popullsisë dhe kohëzgjatjes së komunikimit në publik.

III. TELEVISIONE KABLLORE / IPTV / OTT / PLATFORMA DIXHITALE

Metodologjia dhe masa e tarifave të shpërblimit e aplikueshme për të gjithë subjektet përdorues TELEVISIONE KABLLORE / IPTV / OTT / PLATFORMA DIXHITALE, llogaritet sipas tabelës nr. 4 dhe nr.5 më poshtë.

1) Për subjekte me të ardhura bruto vjetore mbi 5 milion lekë:

Tabela nr.4

Kohëzgjatja e komunikimit në publik të veprës së mbrojtur në programacionin 24 orësh	(deri në 35%)	(36% deri në 65%)	(mbi 65%)
Tarifa në përqindje aplikuar mbi të ardhurat bruto vjetore mbi kufirin prej 5 milion lekë	2%	3%	4%
Formula e llogaritjes së tarifës	2% * të ardhurat bruto mbi 5 milion + tarifën fikse	3% * të ardhurat bruto mbi 5 milion + tarifën fikse	4% * të ardhurat bruto mbi 5 milion + tarifën fikse



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

2) Për subjekte me të ardhura bruto vjetore nën 5 milion lekë:

Tabela nr.5

Kohëzgjatja e komunikimit në publik të veprës së mbrojtur në programacionin 24 orësh	Nr. abonentëve	(deri në 35%)	(36% deri në 65%)	(mbi 65%)
<i>Tarifa fikse</i> përlllogaritur sipas numrit të abonentëve	Nën 250	100.000	150.000	200.000
	251 - 350	150.000	200.000	250.000
	351 – 500	200.000	250.000	300.000
	501 – 650	250.000	300.000	350.000
	651 – 850	300.000	350.000	400.000

Sqarime:

- 1) Subjektet përdorues TV kabllorë që realizojnë të ardhura bruto vjetore mbi 5 milion lekë, në llogaritjen e shumës së tarifës mbajnë parasysh pagesën minimale të garantuar të kategorisë ku ata bëjnë pjesë sipas përcaktimit të numrit të abonentëve dhe kohëzgjatjes së komunikimit në publik të veprës së mbrojtur;
- 2) Për subjektet e transmetimit TV përmes platformave dixhitale, në të ardhurat bruto vjetore, mbi të cilat aplikohet tarifa në përqindje, nuk përfshihen të ardhurat që sigurohen nga shitja / ofrimi i produkteve sportive. Subjekti ofrues i shërbimeve digjitale ka barrën e provës. Në mungesë të saj përqindja e tarifës aplikohet mbi totalin e të ardhurave bruto vjetore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

KREU IV
TARIFA PËR KOMUNIKIMIN NË PUBLIK NË STRUKTURAT
AKOMODUESE (SUBJEKTE PËRDORUES - HOTEL/ MOTEL / NJËSI
AKOMODUESE E TË TJERA TË NGJASHME) TË VEPRËS SË MBROJTUR

Metodologjia dhe masa e tarifave të shpërblimit e aplikueshme për të gjithë strukturat akomoduese,³ llogaritet sipas tabelës nr.1 dhe nr.2 më poshtë.

I. Klasifikimi i strukturave akomoduese sipas ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin” është si më poshtë:

1. “Bujtinë” Standard;
2. “Fjetinë” Standard, Komfort;
3. “Kamping” Standard
4. “Hotel” Dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje;
5. “Motel” Standard, Komfort, Superior;
6. “Resort” Tre yje, katër yje, pesë yje;
7. “Qendër kurative” Dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje;
8. “Fjetje dhe mëngjes” (B&B) Standard, Komfort, Superior

Tabela nr.1

Nr	Përcjellësi në publik i veprës së mbrojtur	Pikët
1	Për përcjellësin qendror	170
2	Për çdo altoparlant	8
3	Për çdo aparat përcjellës nëpër dhoma	17
4	Për çdo aparat përcjellës në mjediset e përbashkëta ⁴ të njësisë akomoduese	46

³ Përkufizimi sipas ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”

⁴ Mjediset e përbashkëta përfshijnë “lobbies”, ambientet e ngrënies dhe të ngjashme, zona argëtuese, etj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

Sqarime:

- 1) Tarifa për llogaritjet mbi baza mujore për dhomat, hollet dhe ambientet e tjera të përbashkëta;
- 2) Për efekte të llogaritjes së tarifës, 1 (një) pikë është e barazvlefshme me 8 (tetë) lekë;
- 3) Kjo tarifë nuk përfshin tipologjinë “BAR” në mjediset e strukturës akomoduese;
- 4) Për të llogaritur vlerën e tarifës mujore subjekti përdorues duhet të deklarojë pranë AAK-së / Sportelit Unik për çdo muaj numrin e dhomave të zëna (shitura). Në rast mos-deklarimi tarifa llogaritjet mbi numrin në total të dhomave të hotelit / njësisë akomoduese;
- 5) Tarifa është shumatorja e të gjithë komponentëve nga nr.1 – 4 (tabela e tarifës nr.1).

*Shembull: Hoteli X ka 1 përcjellës qendror (1 * 170 pikë), 10 altoparlantë të shpërndarë në strukturën akomoduese (10 * 8 pikë), 50 dhoma, secila me 1 aparat TV ose Radio, (50 * 17 pikë) dhe 5 ambiente të përbashkëta ku janë instaluar 5 aparate TV/Radio (5 * 46 pikë). Pas llogaritjeve, hoteli do të paguante për përdorimin e veprave të mbrojtur gjithsej shumën:*

$$(170 + 80 + 850 + 230) * 8 \text{ lekë} = \mathbf{10.640 \text{ lekë në muaj.}}$$

- 6) Tarifat e aplikueshme diferencohen sipas kategorisë ku përfshihet qarku ku është regjistruar struktura akomoduese:

Tabela nr.2

Nr.	Klasifikimi	Tarifa e diferencuar	Qarqet
1	Kategoria I	100% të vlerës së llogaritur	Tiranë, Fier, Gjirokastrë
2	Kategoria II	80% të vlerës së llogaritur	Durrës, Vlorë, Korçë, Berat
3	Kategoria III	70% të vlerës së llogaritur	Dibër, Kukës, Lezhë, Shkodër, Elbasan

- 7) Strukturat akomoduese në bregdet apo destinacione të tjera turistike, pavarësisht kategorizimit të qarqeve, aplikojnë tarifën e plotë në masën 100%.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

KREU V

TARIFA PËR KOMUNIKIMIN NË PUBLIK TË VEPRËS SË MBROJTUR ⁵ NË
VENDET KU KONSUMOHEN USHQIME DHE / OSE PIJE

Metodologjia dhe masa e tarifave të shpërblimit e aplikueshme për të gjitha VENDET KU KONSUMOHEN USHQIME DHE/OSE PIJE llogaritet sipas tabelave më poshtë.

I. Ndarja e subjekteve sipas kategorive/orareve të ushtrimit të aktivitetit:

Kategoria	I	II	III	IV
Tipologjia e aktivitetit	Pub-e, Disko-Clubs, Karaoke, Taverna, Bar i Hotelit, e të tjera të ngjashme me to	Restorante, Birrari, Bar-Caffe, Bufetë, Pasticëri Bistro, Piceri, Zgarat, Wine Bar dhe të ngjashme	Fastfood, si dhe vende të tjera ku nuk shërbehen pije alkoolike	Vende ku nuk konsumohet ushqim dhe pije

Tabela nr.1 Qyteti i Tiranës si dhe zonat turistike në periudhën e sezonit turistik

Oraret e aktivitetit	Pikë	Pikë	Pikë	Pikë
Hapur deri në 9 p.m	750	200	100	50
Hapur deri në mesnatë	1.500	400	200	100
Hapur pas mesnate	3.000	800	400	200

Tabela nr. 2 Qytetet e tjera si dhe zonat turistike jashtë sezonit turistik

Oraret e aktivitetit	Pikë	Pikë	Pikë	Pikë
Hapur deri në 9 p.m	500	150	75	40
Hapur deri në mesnatë	1.000	300	150	80
Hapur pas mesnate	2.000	600	300	150

⁵ Mjedise tregtare me/pa pistë kërcimi për publikun, ku ndikimi i veprës së mbrojtur është thelbësor ose dytësor për zhvillimin e aktivitetit tregtar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

II. Në përcaktimin e tarifës sipas tabelës nr.1 dhe tabelës nr.2 mbahet parasysh kapaciteti i mjedisit si më poshtë:

Niveli	Kapaciteti maksimal i ofrimit të shërbimit	Tarifa e aplikueshme
1	deri në 30 persona	tarifa reduktohet me 30%
2	nga 31 – 100 persona	tarifa aplikohet e plotë 100%
3	nga 101 – 200 persona	tarifa rritet me 50%
4	nga 201 – 500 persona	tarifa dyfishohet
5	nga 501 – 1000 persona	tarifa trefishohet
6	1001 e më shumë persona	tarifa katërfishohet

III. Në rastet e eventeve në diskoteka ku hyrja është me pagesë, tarifa e përcaktuar sipas tabelës nr. 1 dhe tabelës nr.2 aplikohet si më poshtë:

Niveli	Ditë pune gjatë javës	Tarifa e aplikueshme
1	dy ditë në javë	tarifa dyfishohet
2	deri në 4 ditë në javë	tarifa rritet me 30%
3	më shumë se 4 ditë në javë	tarifa rritet me 20%

Sqarime:

- 1) Tarifa është rezultat kumulativ i të gjitha dispozitave të parashikuara më sipër, duke i marrë të gjithë parametrat në konsideratë;
- 2) Në llogaritjen e tarifës në vlerë absolute, 1 (një) pikë është e barazvlefshme me 10(dhjetë) lekë;
- 3) Tarifa llogaritet dhe paguhet mbi baza mujore;
- 4) Me kapacitet maksimal të ofrimit të shërbimit kuptohet numri maksimal i personave që mund t'u shërbehet në mjedisin ku konsumohen ushqime dhe/ose pije;
- 5) Në rast se subjekti përdorues nuk deklaron sa kërkohet për përlllogaritjen e tarifës, tarifa llogaritet mbi të dhënat e siguruara nga palë të treta për këtë subjekt ose përlllogaritet e barabartë me tarifën e llogaritur për një subjekt përdorues me karakteristika të ngjashme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

KREU VI
TARIFA PËR KOMUNIKIMIN NË PUBLIK TË VEPRËS SË MBROJTUR NË
NJËSI TREGTARE DHE MJEDISE TË TJERA BIZNESI

Metodologjia dhe masa e tarifave të shpërblimit e aplikueshme për të gjitha NJËSITË TREGTARE DHE MJEDISE TË TJERA BIZNESI llogaritet sipas tabelave më poshtë.

I. Në këtë Kre përfshihen të gjitha mjediset e mbyllura dhe/ose të hapura të vendosura në një qendër tregtare si vijon:

1. Dyqane dhe njësitë tregtare të shërbimeve të tipit boutique;
2. Mapo;
3. Beaty point;
4. Dyqan pajisjesh elektronike;
5. Galeri të përhershme artistike (pikë shitje);
6. Market/Supermarket;
7. Sallon bukurie;
8. Njësi shitje produkte artizanale;
9. Shërbime të tjera gastronomie që nuk kanë vende akomoduese për klientë (take away) apo të ngjashme me to, etj.

Tabela nr 1. Të dhënat për llogaritjen e tarifës mujore

Nr	Sipërfaqja në m²	Pikë / m²
1	Deri në 50 m ²	1
2	51-200 m ²	0.75
3	Mbi 200 m ²	0.5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

Sqarime:

- 1) Në llogaritjen e tarifës 1 (një) pikë = 10 (dhjetë) lekë;
- 2) Përdoruesit e veprave të mbrojtura, njësi tregtare dhe mjedise të tjera biznesi të vendosur jashtë qendrave tregtare, paguajnë 80% të vlerës së tarifës mujore të llogaritur sipas Tabelës nr. 1;
- 3) Nëse vepra e mbrojtur përcillet në mjedise të hapura / të mbyllura të përbashkëta⁶ publike, koeficienti për llogaritjen e tarifës mujore është 1 (një) pikë / m²;
- 4) Në rastin e panairëve, ceremonive festive, spektakleve dhe tregjeve të përkohshme të natyrave të ndryshme (me raste të caktuara), tarifa ditore është 300 (treqind) pikë;
- 5) Për mjete lëvizëse, të cilat promovonin e realizojnë me altoparlant, tarifa ditore është 10 (dhjetë) pikë.

⁶ Mjediset e përbashkëta (hollet brenda / jashtë, tualetet dhe të tjera të përbashkëta) në qendrat tregtare ku dyqanet administrohen nga subjekte të ndryshëm;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

KREU VII
TË TJERA AKTIVITETE BIZNESI KU KOMUNIKOHEN NË PUBLIK VEPRAT
E MBROJTURA

I. SHËRBIME TË TELEFONISË

Metodologjia dhe masa e tarifave të shpërblimit e aplikueshme për të gjitha subjektet që ofrojnë SHËRBIMET TELEFONIKE “RINGTONE”, llogaritet sipas tabelës nr.1 më poshtë:

Tabela nr.1

Subjekti	Nr. Abonimesh për Rington	Vlera e shitjes Rington-it	Të ardhura bruto vjetore ⁷ nga shitjet Ringtone	Tarifa në %	Tarifa në vlerë monetare
ofrues shërbimi	(a)	(b)	(c) = (a) * (b)	(d)	(e) = (c) * (d)
	x	y	x*y	4%	z=x*y*4%

Sqarime:

- 1) Nëse subjekti ofrues nuk deklaron të ardhurat nga shitja e shërbimit, tarifa do të jetë sa dyfishi i tarifës së llogaritur mbi të ardhurat e periudhës më të fundit të deklaruar;
- 2) Në rast se subjekti ofrues është në treg për herë të parë dhe nuk siguron informacion për të ardhurat bruto nga shërbimi Ringtone, atëherë tarifa do të jetë sa dyfishi i tarifës së llogaritur nga informacione të mbledhura nga të tretë në lidhje me të ardhurat e këtij subjekti.

⁷ Të ardhurat bruto vjetore i referohen vetëm të ardhurave që siguron subjekti përdorues, nga impulset ringtone të shitura për abonentët gjatë vitit kalendarik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

II. TRANSPORTI

Metodologjia dhe masa e tarifave të shpërblimit e aplikueshme për të gjitha MJETET E TRANSPORTIT DHE TERMINALET E UDHËTARËVE që ofrojnë shërbimin e transportit dhe pritjes së udhëtarëve llogaritet sipas tabelës nr.2 më poshtë:

Tabela nr.2

Nr.	MJETET E TRANSPORTIT DHE TERMINALET	Njësia matëse	Pikët
1	Mjetet e transportit për publikun me linja të rregullta (autobuz, tren, anije, aeroplan, etj)	për mjet / në muaj	10
2	Autobuzat e agjencive të udhëtimit	për udhëtim	30
3	Terminalet e pritjes së udhëtarëve	në muaj	400
4	Mjetet e transportit 'Taxi' (Tarifa paguhet nga shoqëritë që ofrojnë këtë shërbim)	për çdo taksi të regjistruar / në muaj	5

Sqarime:

- 1) Vlera e 1 (një) pike është e barazvlefshme me 10 (dhjetë) lekë;
- 2) Në rast të mosdeklarimit të informacionit të nevojshëm për llogaritjen e tarifës, tarifa llogaritet 150% e tarifës më të fundit të paguar;
- 3) Nëse subjekti ka filluar rishtaz aktivitetin, në rast të mosdeklarimit të informacionit të nevojshëm për llogaritjen e tarifës, për të bërë llogaritjet përdoret informacioni i siguruar nga palë të treta për këtë subjekt përdorues.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

III. MJEDISËT KULTURORE, ARTISTIKE, SPORTIVE E TË TJERA TË NGJASHME ME TO

Metodologjia dhe masa e tarifave të shpërblimit e aplikueshme për të gjitha MJEDISËT KULTURORE, ARTISTIKE, SPORTIVE E TË TJERA TË NGJASHME ME TO, që ofrojnë shërbime kulturore, artistike, sportive e të ngjashme llogaritet si më poshtë:

1) KINEMA

Tarifa mujore për përdorimin e veprave të mbrojtura në kinema para, gjatë ose pas shfaqjes, është 10 pikë për shfaqje, por jo më pak se 100 pikë në muaj.

2) MUZE, GALERI DHE EKSPOZITA

Tarifa mujore për përdorimin e veprave të mbrojtura në muze, galeri, ekspozita dhe të ngjashme me to, ku veprat përcillen me mjete të ndryshme është 10 pikë në muaj.

3) MJEDISE SPORTIVE DHE TË TJERA

Tarifa mujore për përdorimin e veprave të mbrojtura në mjedise sportive dhe të ngjashme, gjatë zhvillimit të aktivitetit llogaritet sipas tabelës më poshtë:

Nr.	MJEDISI SPORTIV / TË TJERA	PIKËT / MUAJ
1	Stadium	300
2	Pallat sporti	250
3	Mjedise sportive, pishinat për publikun dhe të tjera të ngjashme	200
4	Sallat e lojrave sportive	50
5	Shkollat e kërcimit për qëllim fitimi/pa qëllim fitimi	500/300
6	Qendrat e fitnesit për qëllim fitimi/pa qëllim fitimi	500/300



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

Sqarime:

- 1) Vlera e 1 (një) pike është e barazvlefshme me 10 (dhjetë) lekë;
- 2) Për rastin e panairëve, ceremonive festive, eventeve, spektakleve dhe tregjeve të përkohshme të natyrave të ndryshme (me raste të caktuara), tarifa ditore është 300 (treqind) pikë;
- 3) Në rast të mosdeklarimit të informacionit të nevojshëm për llogaritjen e tarifës, tarifa llogaritet 150% e tarifës më të fundit të paguar;
- 4) Nëse subjekti ka filluar rishtaz aktivitetin, në rast të mosdeklarimit të informacionit të nevojshëm për llogaritjen e tarifës, për llogaritjet përdoret informacioni i siguruar nga palë të treta për këtë subjekt përdorues.